



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 6 maj.
2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 13-31 maj 2019.
3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. *(Komisioni përgjegjës)*
4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil””. *(Komisioni përgjegjës)*
5. Miratimi i projektzbatimit për veprimtarinë vjetore të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. *(Komisioni përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatik Alimadhi dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Elena Xhina, Tom Doshi

Të ftuar:

Robert Gajda – Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Vilma Çausholli – Përgjegjëse e Sektorit të Analizës Buxhetore në Ministrinë e Financave

Pranvera Strakosha – Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Arbana Basha – Drejtore e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit

Ollga Hoda – Përgjegjëse e Sektorit të Financave dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Enkelejda Hebibasi – Drejtore e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Të futet media!

Nuk ka medie? Dakord, por unë e kam detyrim ligjor ta regjistroj me mikrofon këtë.

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është prezent për të vazhduar me rendin e ditës.

Para se të filloj me rendin e ditës, sot Komisionit të Ligjeve i është bashkuar edhe deputetja Elda Hoti.

Zonja Hoti, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve! Me krahë të lehta!

Në rendin e ditës së sotme kemi tri çështje.

Çështja e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të datës 6 maj.

A jeni dakord me procesverbalin?

A ka vërejtje nga kolegët? Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së komisionit të datës 6 maj.

Çështja e dytë e rendit të ditës është miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 13-31 maj të vitit 2019.

Draftkalendarin e punimeve të komisionit e keni mbi tavolinë.

A jeni dakord me kalendarin?

Në fakt, ju ka ardhur nëpërmjet *e-mail*-it.

A ka sugjerime për kalendarin? Nuk ka.

Miratohet draftkalendarin e punimeve të komisionit për periudhën 13-31 maj 2019.

Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës.

Në fakt, pika 3 dhe pika 4 e rendit të ditës janë projektvendime.

Pika e tretë e rendit të ditës është projektvendimi “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Pika e katërt e rendit të ditës është projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.””

Komisioni ynë është komision përgjegjës për të dyja këto projektvendime. Relatori i projektvendimeve është kolegu Bashkim Fino.

Zoti Fino, vazhdojmë me pikën e tretë. Ndërkohë, relatimin mund ta bëni për secilën pikë veç e veç ose për të dyja bashkë. Kjo është çështje juaja si relator.

Nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konfirmuar pjesëmarrjen komisioneri, zoti Robert Gajda.

Mirë se keni ardhur në komision, zoti Gajda!

Nga Ministria e Financave kemi zonjën Vilma Çausholli, përgjegjëse e Sektorit të Analizës Buxhetore.

Zoti Fino, fjala është për ju. Bëni një prezantim të shkurtër se ku konsiston ky projektvendim.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Ky është vazhdimi i diskutimit që kemi bërë para një jave apo 10 ditësh.

Për të gjitha institucionet, që krijohen me ligj nga parlamenti, strukturën organike e miraton Kuvendi i Shqipërisë dhe vendimet që dalin nga Kuvendi janë në funksion të strukturës dhe tabelës së pagave.

Në rastin konkret, kam kërkuar nga Drejtoria e Monitorimit, të cilën gjej rastin ta falënderoj, të bëjë një unifikim, për t'i trajtuar të gjitha institucionet njësoj, për zbatimin e ligjit nr. 9584 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj.”

Për sa i përket Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kur kemi kaluar vendimin e mëparshëm, kemi menduar që 5 inspektorët në këtë drejtori të trajtoheshin me nivelin III-b. Në fakt, vendimi nr.107 i Këshillit të Ministrave, datë 06.03.2019, ka ndryshuar (e kam këtu edhe vendimin e qeverisë, germën “d”), duke e njësuar me kategorinë III-a. Kjo do të thotë se kategoria III-a për inspektorët nuk është vetëm tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por në të gjitha institucionet, që ne i kemi krijuar me ligj dhe me vendim qeverie.

Pra, ne bëjmë një ndryshim, le të themi, teknik, zoti kryetar. Te vendimi, që do t'ia paraqesim Kuvendit, në organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në pikën 4, thjesht do të ndryshojmë kategorinë e inspektorëve, që janë 5, nga III-b në III-a, sipas vendimit të qeverisë. Nuk do të ndryshojmë numrin, por thjesht do të bëjmë një ndryshim strukturor.

Meqenëse janë dy çështje, po i trajtoj të dyja bashkë. Nuk ka ndonjë problem të madh. Të njëjtën gjë bëjmë edhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Vlen të theksohet (prandaj kërkoja kohë, për të bërë një hulumtim të rëndësishëm) që Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e ka bërë këtë ndryshim kategorie, nga III-b në III-a. Pra, ne kemi miratuar kategorinë III-b, dhe për shkak të vendimit të qeverisë, si të thuash, ata e kanë ekzekutuar.

Për mendimin tim, ky ekzekutim është i padrejtë, sepse struktura dhe organika e pagave miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, por meqenëse ata e kanë bërë fakt të kryer, kanë

fonde page dhe kjo nuk krijon ndonjë problem, për t'i unifikuar institucionet dhe për të qenë korrekt me të gjitha ndryshimet, pavarësisht se ata e kanë vënë zbatim, do të kalojmë një projektvendim edhe për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të trajtuar pikërisht këta që kanë kaluar...

Nga ana tjetër (bëmë mirë që ndërhyrë dhe e pamë), për specialistin e IT-së dhe Burimeve Njerëzore, të gjitha institucionet kanë kategorinë III-b, ndërsa Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e ka pasur IV-a. Kështu që, edhe këtu do të bëjmë ndryshime.

Me këto ndryshime që do të bëjmë sot dhe me këto dy projektvendime që paraqesim në Kuvend, ne jemi, si të thuash, të unifikuar me të gjitha institucionet e krijuara me ligj nga Kuvendi.

Jua thashë, nuk ndryshon numri i punonjësve. Numri i punonjësve është po ai që kemi miratuar në organikën apo në buxhetin e shtetit. Thjesht ndryshon kategorizimi i pagës sipas vendimit të fundit të qeverisë, e unifikuar kjo me të gjitha institucionet përkatëse.

Pra, me pak fjalë, nxjerrim një vendim për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku inspektorët, që paguheshin me kategorinë III-b, do të paguheshin me kategorinë III-a, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Nxjerrim një vendim të dytë edhe për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili do t'i paguajë inspektorët me kategorinë III-a, ashtu sikurse edhe të tjerët, pavarësisht se e ka bërë këtë fakt të kryer. Ndërkohë, edhe specialisti i IT-së dhe i Burimeve Njerëzore do të paguhet me kategorinë III-b, jo me kategorinë IV-a.

Këto janë dy vendimet që ne nxorëm për këto dy institucione. Kështu e unifikojmë strukturën organike të pagave.

Zoti Gajda ka qenë shumë korrekt, zoti kryetar. Mbase nuk ju intereson, por kjo është për t'u vlerësuar. Mbasi doli vendimi i qeverisë, Zoti Gajda mund të kishte vepruar në bazë të vendimit të qeverisë, por e ka dërguar këtu kërkesën, sepse jemi ne organi që bën ndryshimin e strukturës dhe organikës. Kështu duhet të kishin vepruar edhe institucionet e tjera.

Me këto vendime, meqenëse i kam ndjekur të gjitha institucionet nga pikëpamja e organikës dhe e kategorizimit të pozicionit të punës, mendoj se të gjitha institucionet janë të unifikuara.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Nuk besoj se zoti Gajda ka ndonjë gjë për të shprehur, por më intereson të shprehet Ministria e Financave.

(Ndërhyrja pa mikrofon)

A është dakord Ministria e Financave me relatorin, zotin Fino?

Vilma Çausholli – Për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimi nr.187 dhe me ndryshimet e fundit, jemi shprehur dakord për kalimin e inspektorit në kategorinë III-a, njësoj me inspektorët e komisioneve të tjera. Me miratimin e strukturës, fondet janë të mjaftueshme dhe në dispozicion të Komisionerit dhe mund të fillojë kalimi.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Me sqarimin që bëri Ministria e Financave, kur del një vendim qeverie... Mund të bëhet pyetja: “A kanë fonde këta?” Ndryshimi është shumë i vogël...

Ulsi Manja – Edhe unë për fondet e kisha fjalën.

Bashkim Fino – Nuk është ndonjë ndryshim shumë i madh i fondit të pagës. Në momentin kur qeveria e bën vendimin, kjo do të thotë se i ka marrë parasysh këto, sepse fonde rezervë mund të ketë jo vetëm qeveria, por edhe këto institucione.

Kështu që vendimet do të hyjnë në fuqi menjëherë për të dyja institucionet. Pastaj ato do të monitorohen nga Ministria e Financave në vazhdimësi, apo jo?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Kolegët nuk kanë pyetje.

Zonja Hysi, ta mbaroj, se do ta hedhim në votim!

Diskutime nuk ka .

E hedhin në votim projektvendimin “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Kush është dakord me projektvendimin, sipas relatorit, zotit Fino? Kundër? 3 deputetë janë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Zoti Gajda, shumë faleminderit! Ditë të mbarë!

Mund të thërrisni zonjën Strakosha për të vazhduar me pikën e katërt të rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil””. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatik Alimadhi dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Elena Xhina, Tom Doshi

Të ftuar:

Vilma Çausholli – Përgjegjëse e Sektorit të Analizës Buxhetore në Ministrinë e Financave

Pranvera Strakosha – Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Arbana Basha –Drejtoreshë e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit

Ollga Hoda – Përgjegjëse e Sektorit të Financave

Enkelejda Hebibasi – Drejtore e Çështjeve Juridike

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.98/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicionit të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil””. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bashkim Fino.

Kemi prezent Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, zonjën Pranvera Strakosha, si dhe stafin e saj.

Nga Ministria e Financave kemi të pranishme zonjën Çausholli.

Zonja Strakosha, mirë se erdhët në komision!

Në fakt, kolegu im, relatori Bashkim Fino, e bëri relatimin edhe për këtë projektvendim, por, gjithsesi, zoti Fino, është e domosdoshme të sqarohet pozicioni, siç e thatë edhe në fjalën tuaj, që, ndryshe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili pasi ka dalë vendimi i qeverisë iu drejtua Kuvendit për të bërë reflektimin, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e ka aplikuar drejtpërdrejt vendimin, pa qenë i reflektuar në vendimin e Kuvendit. Kjo ndoshta duhet të përsëritet, meqenëse kemi prezent edhe komisionerin.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, ka rëndësi të kuptojmë që ne, jo pa qëllim, i shtymë të dyja projektvendimet për të bërë një unifikim dhe njësim të të gjitha institucioneve përkatëse.

Në rastin konkret, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili sapo u largua, sipas vendimit të qeverisë, të marsit të këtij viti, kërkonte që inspektorët të trajtoheshin me pagën III-a, jo me pagën III-b. Realisht, duhet të ndryshonte organika dhe kategorizimi i pozicionit të pagave, sepse jemi ne organi që e miraton këtë. Ai ishte korrekt, erdhi, e kaloi...

Ndërkohë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me vendim qeverie e ka pasur mundësinë ta bëjë ndryshimin e inspektorëve që nga 2014-a, dhe e ka bërë. Këto janë çështje financiare. Nga pikëpamja financiare, nuk ka asnjë borxh dhe asnjë problem midis Ministrisë së Finance dhe institucionit, por nga pikëpamja e organikës duhet të kalonte në parlament. Duhet ta miratonim këtu ndryshimin e strukturës, që, le të themi, është teknike dhe nuk ka ndonjë gjë që rëndon, sepse ne nuk ndryshojmë, as pozicionin e inspektorëve (i lëmë siç janë, në rastin konkret 6), as numrin e shërbimit civil. Në rast se do të bëheshin këto ndryshime, atëherë do të ishte një gabim shumë i rëndë.

Në rastin konkret, të kalimit të pagave nga III-a në III-b, meqenëse vendimin e qeverisë e ka pasur që në 2014-n, mendoj se kjo është një mungesë korrektësie nga Komisioneri

për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sepse duhet ta sillte këtu për ta ndryshuar. Ne po e bëjmë tashmë organikën e re, siç duhet, pra që inspektorët të trajtohen me kategorinë III-a, qoftë në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, qoftë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes, por ndërkohë, po ndihmojmë dhe po unifikojmë njëkohësisht, që edhe specialistët e IT-së dhe të burimeve njerëzore të mos paguhën me kategorinë nga IV-a, por III-b, sepse kështu e kanë edhe të gjitha institucionet e tjera. Te Shërbimi Civil, në rastin konkret, bëjmë dy ndryshime, të cilat i unifikojmë me të gjitha institucionet e tjera. Inspektorin e lëmë me kategorinë III-a, që ata tashmë e kanë bërë dhe po e marrin, dhe ndërkohë, bëjmë edhe këto dy ndryshime të vogla për specialistët e IT-së dhe burimeve njerëzore nga kategoria III-a në III-b, siç e kanë dhe institucionet e tjera. Ky është projektvendimi që ne marrim sot për Shërbimin Civil.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ministria e Financave.

Vilma Çauholli – Faleminderit!

Ministria e Financave e ka shqyrtuar dhe e ka vlerësuar projektstrukturën megjithëse nuk e kemi sjellë zyrtarisht, sepse është për miratim te ministrja. Në parim ne kemi qenë dakord. Unifikimi i nivelit të pagave është shumë i rëndësishëm për Ministrinë e Financave, pavarësisht se mund të shprehet me kosto të shtuara apo të reduktuara.

Mund të themi vetëm se në ndryshim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të nenit 11 të ligjit vjetor të buxhetit, do të kërkonim që këto efekte financiare, pavarësisht se janë minimaliste, të fillojnë nga data e ndryshimit të ligjit të buxhetit, që të jemi në përputhje me nenin 11 të ligjit, ku thuhet: “Ndryshimi i strukturave nuk bëhet në asnjë rast me kosto shtesë financiare”.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Të jemi të qartë. Kur morët vendimin e qeverisë të marsit të vitit 2019, ne si parlament nuk na pyetët. Kjo do të thotë se ju kishit mundësi financiare për ta paguar Kryeinspektorin, që sapo doli, nga kategoria III-b me kategorinë III-a, ndërkohë që ne në strukturë e kishim III-b. Ju morët një vendim ku thuhet se e unifikojmë, dhe unë jam plotësisht dakord me unifikimin e pagave, dhe vendosët të paguani. Pra, ti nuk e more vendimin nga Kuvendi për ta ndryshuar këtë strukturë dhe pastaj të thoshe nëse ke apo jo mundësi. Në rastin konkret, nuk mund ta thuash këtë fjali, sepse ligjin dhe ndryshimin e vendimit ne do ta bëjmë tani. Pra, ndryshimi do të bëhet gjatë muajit maj, do të hyjë në fuqi menjëherë dhe do të bëhet efektiv pas 1 qershorit. Por, 5 muajt e kaluar, për hir të së vërtetës, punonjësit janë paguar padrejtësisht me pagë më të vogël. Ne do të themi “Hyn në fuqi menjëherë dhe nuk do të ketë

fuqi prapavepruese për kohën e kaluar”. Unë nuk mendoj, për ndryshimin e vogël që thatë ju, që për 6-7 muaj nuk kanë mundësi të paguajnë 2 specialistë, sepse nuk bëhet fjalë për 12 inspektorë, sepse inspektorët i ka paguar me vendimin që ti ke nxjerrë në vitin 2014.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni, se unë jam ekonomist dhe nuk mund të flas kështu.

Këtu bëhet fjalë për dy paga, që u shtohen 50-60 mijë lekë, që edhe vetë institucioni brendapërbrenda mund të këtë mundësi. Nëse bëjmë analizën e tij, i ka edhe vetë mundësitë financiare për dy punonjës. Pra, nuk mund ta thoni këtë gjë, aq më tepër kur ne kemi marrë mendimin e DAP-it, i cili është shprehur dakord dhe vendimet e qeverisë janë të unifikuara me këto dy vendime që bëjmë ne me Ministrinë e Financave.

Dua të them se të gjithë specialistët e IT-së dhe të burimeve njerëzore në të gjitha institucionet, zoti kryetar, që kemi ne këtu, edhe ata që sapo ikën, paguhen me III-b. Pse duhet të paguhen dy punonjës të saj me IV-a? Ne këtë kërkuam, që unë e shtyva materialin tjetër para 4 ditësh dhe kërkoja ta unifikoja. Do të thotë se duhet të jetë e njëjtë për të gjithë. Pikërisht, duke u nisur nga thelbi, që unifikimi është i domosdoshëm, mendoj se nuk është fare problem, as për institucionin, që mund t’i ketë këto fonde, as për Ministrinë e Financave, që po të më lini kohë 5 minuta, do t’ju them edhe efektin financiar, që është kaq qesharak, saqë ju të gjithë do të qeshni dhe do të thoni se do ta miratoni menjëherë. E dini sa mund të jetë efekti financiar? Nëse do të shumëzoni 500 mijë lekë të vjetër për 6 muaj, 300 mijë dhe 300 mijë, do të shkojnë 600 mijë të reja. Është turp që për 6 milionë lekë të vjetër të thonë nuk kanë mundësi t’i paguajnë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë për pikën e katërt. Duke qenë se vendimi i qeverisë ka filluar të aplikohet që në vitin 2014, pa kaluar ndryshimi përkatës i vendimit nr. 98 i vitit 2014 të Kuvendit, përbën ndonjë shkelje, zoti Fino?

Bashkim Fino – Unë e thashë dhe po e përsëris sërish se është një gabim teknik nga institucioni, por Ministria e Financave thotë se i ka mundësitë financiare thotë që i ka pasur mundësitë financiare, i ka trajtuar dhe i ka paguar,. Ne, zoti kryetar, na kanë ndodhur edhe në raste të tjera, që kemi miratuar numrin dhe pagesën e institucioneve të tjera dhe nuk e ka zbatuar sa duhet Ministria e Financave. Në rastin konkret e ka zbatuar për mirë dhe duhet ta themi këtë gjë që ka ndodhur nga viti 2014. Duke marrë anën pozitive të saj, them se ka bërë mirë që e ka bërë institucioni bashkë me Ministrinë e Financave, pavarësisht se ne sot e kalojmë strukturën, që i miratojmë inspektorët në III-a.

Ulsi Manja – Dakord.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Strakosha, situata është e qartë.

Pranvera Strakosha – Sa për korrektesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pranvera Strakosha – Jo, nuk e prish.

Ulsi Manja – Edhe unë e di që do ta prishësh, megjithatë, meqenëse ke ardhur, thuaji dy fjalë.

Pranvera Strakosha – Pse më paragjykoni, kur nuk do ta prish?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, folët shumë mirë dhe unë jam dakord.

Është bërë ndryshim në VKM në vitin 2015 dhe, pranë këtij komisioni të nderuar, kemi paraqitur VKM-në, që bashkë me strukturën të ketë edhe shtim të numrit të inspektorëve. Nga komisioni juaj i nderuar u miratua shtimi, por nga Komisioni i Ekonomisë nuk u miratua dhe në projektbuxhet nuk u reflektua shtimi i inspektorëve, por ishte reflektuar shtesa për inspektorët. Duke e marrë të mirëqenë këtë gjë, është sigurisht harrimi ynë që të bënim një kërkesë të dytë që të thoshim se meqë nuk u miratua shtesa, të miratohet vetëm ndryshimi. Pra, e pranoj gabimin, por, si të thuash, e sollëm bashkë dhe menduam se e kaluam.

Ulsi Manja – Dakord.

Faleminderit!

Hedhim në votim projektvendimin. Kush është dakord? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Asnjë.

Miratohet projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

Zonja Strakosha dhe zonja Causholli, faleminderit!

Ditë dhe javë të mbarë!

Sekretare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

“Miratimi i projektrezolutës për veprimtarinë vjetore të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”. *(Komisioni përgjegjës)*.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatik Alimadhi dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Elena Xhina, Tom Doshi

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e pestë dhe të fundit të rendit të ditës, “Miratimin e projektrezolutës për veprimtarinë vjetore të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bahskim Fino. Siç duket, sot ka qenë dita e zotit Fino.

Projektrezolutën e keni në tryezë, është e hapur për sugjerime, komente dhe diskutime. Përpara se të votojmë tekstin final, keni komente?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, në mos gaboj, ne para 2-3 ditësh e kaluam Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive, e trajtuam dhe e diskutuam gjerë e gjatë këtu, ku vërtetuam me koshiençë se rezoluta e vitit të kaluar është pothuajse e realizuar plotësisht. Unë e paraqita këtu në formë tabele atë që ishte vendosur për vitin 2018 dhe atë që ishte realizuar. Do të më falni, sepse këtë gjë e kisha personale, e kisha bërë vet. Jua kam dhënë edhe juve, por mendova se ishin të realizuara të gjitha gjërat.

Nga ana tjetër, projektrezoluta e re është bërë në funksion të diskutimit dhe pyetjeve që ne bëmë javën e kaluar dhe nuk është trajtuar asgjë nga projektrezoluta e vjetër, që ishte realizuar, sepse ne presupozojmë që në projektrezolutën e realizuar nuk mund të vëmë pika për projektrezolutën e vitit 2019, por kemi vënë probleme të tjera, që u trajtuan me kujdes, edhe nga pyetjet, edhe nga sugjerimet që bëri kryeinspektori. Janë 6 çështje që mendoj se, e para, të vazhdohet në procesin e dorëzimit, dhe është detyra e tyre, të dosjeve të raporteve të hollësishme të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve për vetëgung.

E dyta, të vijohet angazhimi, së bashku me partnerët ndërkombëtarë, për të garantuar atë që ne kërkuam dhe inspektori na tha se mund të bëhet edhe para vitit 2021 për të dhënat *online*. Ne do ta vëmë edhe më parë, sepse përderisa është afati viti 2021, ne do të shikojmë në fund çfarë do të realizohet, do të realizohet apo do të bëhet pas vitit 2019.

E treta, të forcohet më tej kapaciteti investigues në fokusin e veçantë të trajtimit të rasteve të fshehjes apo mosdeklarimit të pasurisë, konfliktin e interesit, si dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit. Ky ishte një nga diskutimet e veçanta që ne bëmë.

E katërta, të vijojë aktiviteti informues, sidomos për ligjin nr. 60/2018, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ku vet kryeinspektori kërkoi të bënte disa ndryshime dhe ne jemi të hapur të na paraqesë informacion. Këtë detyrë i kemi lënë gjatë vitit 2019, që nëse ka informacione dhe mendime sugjeruese për këtë projektligj, të na e paraqesë dhe më pas e kemi ne iniciativën ligjvënëse për të bërë ndryshimet e nevojshme.

E fundit, kemi kërkuar të pasurohet raporti vjetor me të dhënat statistikore, ato që kërkova edhe unë me forcë. Kjo është zbutur këtu, është bërë më e rrumbullakët, por gjithsesi,

edhe kaq është mirë “për kategoritë e zyrtarëve për të cilët është kryer kontrolli i plotë i vitit për verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave të përmbajtura në deklarimin e pasurisë së interesave private, të cilat janë rezultat i këtyre kontrolleve”.

Mendoj se këto çështje janë shumë të rëndësishme mbi bazën e atyre që ne diskutuam para 4-5 ditëve.

Bëra këtë rezymë, zoti kryetar, për të ndihmuar kolegët deputetë dhe për t’i futur në diskutimin që ne bëmë para 4-5 ditëve këtu, që bëmë pyetje dhe diskutime, pa dashur t’i fus në vorbullën e tyre. Shpresoj të kem qenë i qartë.

Ulsi Manja – Ishit shumë i qartë, zoti Fino.

Ka ndonjë gjë për të shtuar nga kolegët për relatimin e zotit Fino? Nuk ka.

Hedhim në votim këtë projektrezolutë.

Kush është dakord me tekstin e projektrezolutës, që do t’i drejtohet seancës për votim? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Asnjë.

Miratohet projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2018”, sipas tekstit që ne sapo votuam.

Me votimin e kësaj rezolute, e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

Ditë dhe javë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA